

VENDIM
Nr. 92, datë 19.2.2014

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 42, DATË 16.1.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KRITERET, PROCEDURAT E DHËNIES SË
LICENCAVE PROFESIONALE TË ZBATIMIT, KLASIFIKIMIT DHE DISIPLINIMIT TË
SUBJEKTEVE JURIDIKE QË USHTROJNË VEPRIMTARI NDËRTIMI”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 e 18 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në rregulloren për kriteret, procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, të klasifikimit dhe të disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, që i bashkëlidhet vendimit nr. 42, datë 16.1.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi i dytë i pikës 2 të kreut I “Përkufizime, ndryshohet si më poshtë vijon:

“**Komision**”, struktura e posaçme administrative që krijohet sipas shkronjës “a” të pikës 1 të kreut II të kësaj rregulloreje e që asistohet nga stafi përgjegjës për veprimtaritë e licencimit në ministri, që ka autoritetin e vetëm për dhënien, ndryshimin a revokimin e licencave profesionale të shoqërive apo vendosjen e penaliteteve për subjekte që kryejnë veprimtari në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi brenda sferës së përgjegjësisë, që i janë dhënë sipas kësaj rregulloreje në fushën e zbatimit në ndërtim.”.

2. Shkronja “a” e pikës 1 të kreut II, ndryshohet si më poshtë vijon:

“a) Komisioni i Posaçëm i dhënies së licencave profesionale përbëhet nga pesë anëtarë:

- një përfaqësues nga Kryeministria, i cili do të jetë kryetar i Komisionit;
- një përfaqësues nga Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit;
- dy përfaqësues nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës;
- një përfaqësues nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë.

Detyrën e sekretariatit teknik të Komisionit e kryen drejtoria përgjegjëse për licencimin në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës.”.

3. Kudo në rregullore, emërtimi “... Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit ...”, zëvendësohet me “ ... Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës...”, ndërsa emërtimi “... sekretari teknike ...”, zëvendësohet me “... sekretariati teknik ...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama